

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJETLLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.

Nr. _____ Prot.

Korçë, më 16.2.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Ndërtim pus shpimi, godinë stacioni dhe linjë transmetimi në fshatrat Zëmbllak, Tren dhe Sovjan”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45247130-0 Punime ndërtimi për ujësjetllës; 45255110-3 Punime ndërtimi për puse

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/ vlera e pritshme e kontratës: 17.787.047 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyzetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Përlllogaritja e fondit limit është bërë në mbështetje të Ligjit Nr. 162 dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar nenit 34, si dhe të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, neneve, 12, 39 dhe nenit 76.

Në këtë procedurë për punë publike, çmimet janë sipas sistemit të integruar të manualit të çmimeve në ndërtim, në portalin e-albania, konkretisht sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.216. datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK Sh.A) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 me vlerë **355.740,94 (treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e dyzet presje nëntëdhjetë e katër) Leke** (2% të vlerës së përlllogaritur të kontratës).
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Bendis Samarxhi

Resmir Rrezhda

Thoma Koroveshi

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore gjatë tre viteve 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 17.787.047 lekë. Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim nga Dega e Tatim-Taksave ose vërtetim elektronik nga shërbimet e-Albania.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e sipërpërmendura ku përcaktohet:

Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave **të xhiros vjetore** të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare**. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) **vlerën e përllëgaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare **konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK Sh.A , për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 61, të Ligjit Nr. 29, dt. 30.3.2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

2.1.2 Kopje të vërtetuar të bilancit për tre vitet 2022, 2023 dhe 2024 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse tatimore, me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt - Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm kur janë në kushtet e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, kreu V, neni 41, pika c.

*** Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Bendis Samarxhi

Resmir Rrezhda

Thoma Koroveshi

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 8.893.523,66 (Tetë milion e tetëqind e nëntëdhjet e tre mijë e pesëqind e njëzet e tre presje gjashtëdhjet e gjashtë) lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 35.574.000 (tridhjet e pesë milion e pesëqind e shtatëdhjet e katër mijë) Leke pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Ne rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike, Pika 2.2.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.2.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me institucione shtetërore :

- kontratë
- situacion përfundimtar
- akt kolaudimi
- formular vlerësimi

Për kontrata të realizuara me subjekte private:

- kontratë
- situacioni përfundimtar
- vertetim për kryerjen me sukses të kontratës
- faturën përkatëse tatimore të deklaruar pranë organeve tatimore

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e ngjashme për një objekt të vetëm të jete ne nje vlere jo me te madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, ose të jenë minimalisht sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punë e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerat si më sipër, që janë brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A., per aftesinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit te prokurimit dhe që ka aftesinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

Bendis Samarxhi

Resmir Rrezhda

Thoma Koroveshi

2.2.2. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë MIE/ ose MPPT/ ose MTI ose licencën profesionale të ekuivalentuar në Shqipëri për operatorët e huaj, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT

- a. N.P – 1 A (Punime gjurmimi në tokë)
- b. N.P – 2 A (Ndërtim civil dhe industrial)
- c. N.P – 7 A (Ujësjetës, gazjetës, vajjetës, vepra kullimi e vaditje)

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- a. N.S. – 4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)
- b. N.S. – 18 A (Punime topogjeodezike)
- c. N.S. – 20 A (Shpime gjeologjiko-inxhinierike, puse e shpime për ujë)

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 3, 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e

rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.”, i ndryshuar.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Kriteri lidhur me kategorinë e licencave profesionale, në fushën e zbatimit në ndërtim, nivelet e klasifikimit të kategorive janë në përputhje me natyrën e kontratës dhe në përpjestim me volumet e punimeve.

Vendosja e këtij kriteri, që ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, bazohet në:

- a. Tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet dhe vlerën limit të parashikuar;
- b. Zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe vlerat e parashikuara në secilin prej tyre në hartimin e fondit limit;
- c. Përshkrimin e veprimtarive konkrete të parashikuara për t’u realizuar në specifikimet teknike;
- d. Kategoritë e punimeve të zbatimit në ndërtim, përshkrimin e secilës prej tyre dhe vlerat në lekë që i përkasin klasifikimeve të specifikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike , që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.”, i ndryshuar;

Për:

- a. N.P – 1 A (Punime gjërmimi në tokë)
- b. N.P – 2 A (Ndërtime civile dhe industriale)
- c. N.P –7 A (Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje)

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- a. N.S. – 4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)
- b. N.S.-18 A (Punime topogjeodezike)
- c. N.S. – 20 A (Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë)

Niveli i klasifikimit korespondues është niveli “A”, i cili është për vlerë pune 0-20 milion Lekë.

Niveli i klasifikimit korespondues është niveli “B” i cili është për vlerë pune 21-50 milion Lekë.

Niveli i klasifikimit korespondues është niveli “C”, i cili është për vlerë pune 51-100 milion Lekë.

Shpjegime për kategoritë e punimeve të zbatimit në ndërtim.

NP – 1 A (Punime gjërmimi në tokë).

Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

NP – 2 A (Ndërtime civile dhe industriale)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina

industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

N.P – 7 A (Ujësjiellësia, gazsjellësia, vajsjiellësia, vepra kullimi e vaditje)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjiellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura

N.S. – 4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

N.S. – 18 A (Punime topogjeodezike)

Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

N.S. – 20 A (Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë)

Përfshihen shpimet për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik. Shpimet për ujë dhe puse.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP – 1 A	Punime gjurmimi në tokë	Gjurmim themel i vecuar, tokë e fortë me h = 1.5 m	0-20ml leke	108.000
NP – 2 A	Ndërtime civile dhe industriale	Ndërtim godine pusi fshati Zemblak, Tren dhe Sovjan	0-20ml leke	1.800.000

NP – 7 A	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje	Punime hidro-mekanike ne stacionin e pompave Zemblak	0-20ml leke	600.000
N.S.– 4 A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	Suva brenda mur tulle ~4m, me krah, llaç perzier M 25 Suvatim solete. Suvatim i jashtëm i zakonshem	0-20ml leke	800.000
N.S.–18A	Punime topogjeodezike	Piketimi i objekteve civile	0-20ml leke	100.000
N.S. – 20 A	(Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë)	Shpim pusi ne fshatin Tren dhe Zemblak	0-20ml leke	6.000.000

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier **Gjeolog /Hidrogeolog**
- 1 (një) Inxhinier **Hidroteknik** ose 1 (një) Inxhinier **Ndertimi** në varësi të asaj çka është drejtuesi teknik: nëse drejtuesi teknik është Inxhinier **Hidroteknik**, ndërsa nëse drejtuesi teknik është Inxhinier **Ndertimi** atëherë duhet edhe një Inxhinier **Hidroteknik**.
- 1 (një) Inxhinier **Mekanik**
- 1 (një) Inxhinier **Elektrik**

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

- kontratë pune të vlefshme, diplomë. dhe të paraqiten listpagesat e E-Sig të shoqërisë minimalisht të muajit të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipërm duhet të figurojnë sipas kodit përkatës të profesionit.***

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që

operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierin Hidroteknik ose 1 (një) Inxhinier Ndertimi në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza profesionale e inxhinierit drejtues janë:

1 (një) Inxhinier Hidroteknik ose 1 (një) Inxhinier Ndertimi	Ndjekja e punimeve ndertimore ne godina dhe te punimeve hidroteknike per instalimin e rakorderive speciale
--	--

Nevoja për inxhinierin **Hidrogeolog** në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza profesionale e inxhinierit Hidrogeolog janë:

1 (një) Inxhinier Hidrogeolog	Ndjekja e punimeve te pus shpimit si dhe punimet per shtresat dhe konstruksionin e pusit
--------------------------------------	--

Nevoja për inxhinierin **Mekanik** në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza profesionale e inxhinierit Mekanik janë:

1 (një) Inxhinier Mekanik	Instalimi i pompave zhytese dhe rakorderive speciale ne stacione
----------------------------------	--

Nevoja për inxhinierin **Elektrik** në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza profesionale e inxhinierit Elektrik janë:

1 (një) Inxhinier Elektrik	Ndjekja e punimeve elektrike per linjat ajrore, kabinat shtyllore dhe inverterat
-----------------------------------	--

2.2.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si më poshtë:

- a. 1 (një) Hidraulik

- b. 1 (një) Karpentier
- c. 1 (një) Hekurkthyes
- d. 1 (një) Teknik Mekanik
- e. 1 (një) Elektricist
- f. 1 (një) Bojaxhi/Suvaxhi
- g. 1 (një) Murator
- h. 1 (një) Hidroizolues
- i. 1 (një) Saldator
- j. 2 (dy) punëtorë krahë

Shënim: Gjate fazes se ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) - Deklarata - “*Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate*”, operatorët ekonomik për punonjësit e mesiperm **duhet të deklarojnë:** emer/mbiemer, profilin e punës, subjektin leshues të certifikates/diplomes, Nipt (ne rastin kur subjekti leshues i certifikates/diplomes është privat).

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

***Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.**

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtem:

Per punonjësit e mesiperm duhet të paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*”, i ndryshuar.
- Të paraqiten listepagesat përkatëse të shoqërisë minimalisht e muajit të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për 2 (dy) punëtorët e krahut duhet të paraqiten vetëm kontratat e punës të vlefshme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Bazohet në përcaktimin ligjor që kritret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kërkesa për disponimin e 1 (një) hidrauliku është vendosur sepse ky punonjës i kualifikuar do të shërbejë për montimin e tubacioneve dhe rakorderive në stacionin e pompave.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 (një) karpentieri i cili do të shërbejë për ndërtimin e pusetave dhe punimet e betonit dhe kallëpeve të betonimit të godinave të st/p. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 (një) Hekurkthyesi i cili do të shërbejë për vendosjen e armaturave të hekurit në të gjithë objektet b/a si puseta, puseta komandimi, puseta ajrimi. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 (një) Tekniku Mekanik i cili do të shërbejë për montimin instalimit të pompave dhe të rakorderive si të saraqineskave, kond/valvulat etj në st/p. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 (një) Elekticisti i cili do të shërbejë për lidhjet e energjise elektrike dhe instalimet e brendshme të gjithë prizave celesave dhe kablllove në godinat e st/p. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 (një) Bojaxhi/Suvaxhi i cili do të shërbejë për lyerjen e objekteve si dhe realizimin e shtresave të suvasë. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 (një) Muratori i cili do të shërbejë për ndërtimin e mureve të godinave të st/p Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 (një) Hidroizoluesi i cili do të shërbejë për ndërtimin e hidroizolimit të soletës së godinës. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 (një) Saldatori i cili do të shërbejë për saldimin e tubacioneve të inoksit në godina e stacionit dhe në puseta si dhe saldimet e rakorderive të tjera si flanaxha dhe tronketa.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 2 (dy) punëtorëve të krahut, të cilët do të shërbejnë për realizimin e volumeve të gërmimit me krahë, rektifikimin e skarpave të kanaleve ku do të vendosen tubacionet, mbulimet me krahë dhe përdorimin e tokmakut elektrik për mbulimet e kanaleve, gërmimet si dhe si ndihmës të hidraulikëve, karpentierëve, hekurkthyesëve etj për sistemimin, shkarkimin dhe transportin në kantier të materialeve të ndryshme. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Sqarojmë se për 2 (dy) punëtorët e krahut duhet të paraqiten vetëm kontratat e punës të vlefshme.

2.2.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë ***punonjës të kualifikuar*** për kryerjen e punimeve, të cilët duhet të jenë të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale, që të vërtetojë kualifikimin profesional, sipas profileve të më poshtme:

- **Shofer 1 (një)**

Shenim: Gjate fazes së ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) - Deklarata - "*Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate*", operatorët ekonomik për punonjësit manovrator, dhe shofer, **duhet të deklarojnë:**

emer/mbiemer, profilin e punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe datën e vlefshmerise se saj.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtem:

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratae punës individuale e vlefshme.
- Dëshmi te Aftësisë Profesionale, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me Urdhrin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor.
- Të paraqiten listepagesat përkatëse të shoqërisë minimalisht e muajit të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

- Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizikë, të cilët janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere shoferi nuk ka nevojë që të figurojë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues, por mund të disponohet nga ai edhe nëpërmjet kontraktimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshar, si dhe ne Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Bazohet në përcaktimin ligjor që kritret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 shofer kamioni i cili do të shërbejë për drejtimin e bobcatit, kamioneve te transportit si dhe të kamionçinës dhe mjeteve të tjera, për sistemim e mbulimeve me dhera dhe transportin e materialeve të ndërtimit. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 16 persona.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Për pikat 2.3.5 dhe 2.3.6 operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, ***përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit***, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

Listpagesat e sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga organet tatimore, për periudhën kohore: Dhjetor/Janar 2026 për punësimin e mesatarisht 16 personave”

Argumentimi: Përcaktimi i numrit të punonjësve bazohet tek Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore dhe tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje Dhjetor/Janar 2026, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës.

Numri i punonjësve të kërkuar është vendosur minimalisht 16 persona sipas kriterëve me sipër: Perkatesisht 1 Hidraulik + 1 Karpentier + 1 Hekurkthyes + 1 Teknik Mekanik + 1 Elektracist + 1 Bojaxhi/Suvaxhi + 1 Murator+ 1 Hidroizolues + 1 Saldator + 1 Shofer + 2 Punëtorë krah + 4 Inxhinër së bashke me drejtursin teknik = 16 persona.

Periudha kohore e listpagesave të sigurimeve shoqërore është përcaktuar periudha Dhjetor/Janar 2026, në mënyrë që kriteri të përfshijë një periudhë sa më koherente.

Vlerësohet domosdoshmëria e stafit të punësuar për një periudhë të mëparshme, periudhën: Dhjetor/Janar 2026, duke argumentuar se kjo shërben si tregues i një marrëdhënie të besueshme e të qëndrueshme midis punëdhënësit e punëmarrësit.

2.2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Fadrome me goma (bobcat ose ekuivalente)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamion me vinq	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamionçinë deri në 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobot Uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
Pompe Uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
Motogjenerator / Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autosondë për hapje pusi dhe vendosjen e tubave në pus	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kompresor për futjen me presion të ajrit dhe solucionit në pus	në pronësi ose me qira	Copë 1

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (I vlefshëm).

Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (I vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara nga OE.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lloji dhe sasia e makinerive të kërkuara është përcaktuar në raport (në përpjestim) me punimet konkrete që do të kryhen, volumet e tyre dhe grafikun e punimeve.

2.2.7 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilesisë) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .
- ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- ISO 39001 (Sistemi i menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Standardet e referencës janë ato shqiptare dhe standardet e vendeve të Bashkimit Europian EEC që konsiderohen si ekuivalente.

Argumentimi 2.2.7: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë.Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë per Sistemin e manaxhimit te cilesise ISO 9001 (e vlefshme) për të garantuar kërkesat cilësore të materialeve të ndërtimit dhe punimeve të zbatimit ose ekuivalente.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë per Sistemin e manaxhimit te mjedisit ISO 14001 (e vlefshme) ose ekuivalente, për të garantuar rehabilitimin e plotë të sheshit të ndërtimit gjatë dhe pas kryerjes së punimeve me ndikime sa më të vogla në mjedis.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë per Sistemin e manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune ISO 45001 (e vlefshme) ose Çertifikatën ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018 për të garantuar sigurinë e punëtorëve të zbatimit gjatë kryerjes së punimeve

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemi i menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001 (e vlefshme) ose Çertifikatën ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare ISO 39001-2012 për të garantuar sigurinë e punëtorëve të zbatimit gjatë kryerjes së punimeve.

NJËSIA E PROKURIMIT

Bendis Samarxhi

Thoma Koroveshi

Resmir Rrezhda